



Dr. Enkeleda Shehi

Përgjegjëse e Departamentit të Biznesit dhe Financës
Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College

Dr. Enkeleda Shehi është Përgjegjëse e Departamentit të Biznesit dhe Financës në Tirana Business University, TBU. Dr. Shehi është pjesë e stafit akademik të Tirana Business University që prej vitit 2018, si lektore e jashtme dhe nga viti 2019 – 2023 si Përgjegjëse e Departamentit të Lëndëve të Përgjithshme në TBU. Dr. Shehi është diplomuar në Master in Business Administration, University of Nebraska–Lincoln & Universiteti i Tiranës, Master i Shkencave në Matematikë, Universiteti i Tiranës dhe Doktore e Shkencave në Statistikë, Universiteti i Tiranës.

Dr. Shehi ka një eksperiencë mbi 10 vjeçare në rregullimin e tregjeve financiare jobankare, si: tregu i sigurimeve, tregu i kapitaleve, përfshirë dhe bursën, si dhe tregu i pensioneve private. Ajo është njohëse e mirë e ligjeve si dhe legjislacionit/direktivave përkatëse të BE-së në këto tre fusha. Për një periudhë pesëvjeçare ajo ka qenë kryetare e bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (2 vjet) dhe Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive dhe Anëtare e Bordit të AMF (3 vjet). Si kryetare dhe anëtare e Bordit të AMF-së ajo ka kontribuar në hartimin dhe amendimin e disa projektligjeve, lidhur me veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, fondet e pensionit vullnetar dhe për veprimtarinë e AMF-së, si dhe në hartimin dhe miratimin e shumë akteve rregullatore dhe në mbikëqyrjen dhe zbatimin e tyre nga aktorët e tregjeve.

Ajo zoteron përvojë e pasur në bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, të tilla si: IAIS, IOCSO, IOPS, rregullatorët partnerë të mbikëqyrjes financiare. Ajo ka marrë pjesë si paneliste në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është një ndër aktualet e para në vend, e licencuar në 2011, si dhe nenkryetare e shoqates së aktualeve shqiptare, që nga viti 2017. Ajo ka aftësi të forta analitike dhe aftësi të larta për të ndërmarrë kërkime shkencore. Dr. Shehi zoteron përvojë të konsiderueshme në sistemin e arsimit të lartë, ku ka kontribuar si pedagoge e jashtme (Fakulteti Gjeologji Miniera, Universiteti i Tiranës, Universiteti European i Tiranës). Përgjatë gjithë karrierës së saj ajo ka mbajtur poste drejtuese në departamente të lidhura me statistikën, aktuaristikën, kërkimin shkencor, etj.